



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 760/1 Prot.

Tiranë, më 16 . 05 . 2024

V E N D I M

Nr. 137, Datë 16 . 05 . 2024

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 228, datë 25.10.2023, e M.K kundër Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU), në të cilën pretendohet për diskriminim për “çdo shkak tjetër¹”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: “Në datë 14.09.2021, pas një denoncimi të ardhur në portalin info@aku.gov.al, për subjektin E.M, nga Drejtoria Rajonale AKU Fier, u caktova unë dhe inspektorja D.S për kryerjen e këtij inspektimi në këtë subjekt. Nga inspektimi u konstatuan shkelje të rënda të kushteve higjieno-sanitare si dhe problematika të tjera të lidhura me sigurinë ushqimore. Në momentin e inspektimit subjekti nuk dispononte asnjë dokumentacion për produktet ushqimore që ai tregtonte si dhe librezat e shëndetit dhe planin D.D.D (detyrim i subjekteve që trajtojnë produkte ushqimore) por që ai pretendonte që i kishte tek ekonomisti. Për këtë arsye, në zbatim të ligjit, subjektit iu dhanë njëzet e katër orë kohë për paraqitjen e dokumentacionit për të cilin pretendonte që i kishte. Ditën e nesërme, në datë 15.09.2021, u paraqitëm tek subjekti me autorizim të rinovuar nga Kryeinspektori por subjekti u paraqit përsëri në të njëjtën gjendje, nuk dispononte asnjë dokumentacion.

¹ Për shkak se ishte në proces gjyqësor.

Në zbatim të ligjit të ushqimit dhe inspektimit për subjektin u vendos masa “Pezullim i aktivitetit” si dhe u vendos gjobë për “Mosplotësim të kushteve Higjeno-Sanitare” dhe “Mungesë dokumentacioni për gjurmueshmërinë e ushqimit” sipas nenit 68, të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008. Në përfundim të procedurës së inspektimit të kryer, subjekti E.M ka refuzuar të firmosë.

Në datë 08.11.2021, nga Inspektori i Antikorrupsionit të atashuar pranë Drejtorisë Rajonale AKU Tiranë, nëpërmjet e-mail-it, kërkohet një informacion për çfarë kishte ndodhur gjatë inspektimit në këtë subjekt. Duke qenë se atë ditë inspektimi që më ishte caktuar ishte shumë larg, përgjigjja u kthye në datën 09.11.2021 në mëngjes, por as dy orë pasi u dërgua përgjigjja e e-mail-it, në televizion u publikua lajmi ku edhe kërkohet që të ndiqeshim penalisht. Po në datë 09.11.2021, po me e-mail, na u komunikua pezullimi nga detyra deri në zbardhjen e kësaj ngjarje, duke qenë se ndërkohë Ministria e Drejtësisë kishte bërë kallëzim penal lidhur me këtë ngjarje. Në datë 22.11.2021, u mor masa “Arrest me burg” duke më çuar në ambientet e paraburgimit në I EVP Fier. Në datë 17.12.2021 u zhvillua seanca gjyqësore në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila ma lehtësoi masën duke më lënë në “Arrest shtëpie”. Ndërkohë që çështja ishte ende në gjykim, në datë 29.12.2021, më largojnë nga puna, pikërisht për këtë çështje.

Pas gjyqimit të çështjes, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, me Vendimin nr. 62-2023-2261 (278), datë 08.06.2023 vendosi: “Pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit M.K për kryerjen e veprës penale të “Korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike”, sipas nenit 259 të Kodit Penal”. Vendimi ka marrë formë të prerë në datë 26.07.2023, pasi nuk është ankimuar nga palët.

Komisioni i Shqyrtimit të Masave Administrative në Ministrinë e Bujqësisë me Vendimin nr. 51, datë 23.03.2023, ka vendosur: “Rrëzimin e ankesës të subjektit E.M, lënien në fuqi të masës objekt ankimi – Vendimi përfundimtar i inspektimit me nr. AKU-FR-2021-002271-5, datë 15.09.2021”. Gjithashtu Drejtoria Rajonale AKU Fier ka kryer edhe arkëtimin e gjobës me vlerë 400.000 lekë, të vendosur gjatë inspektimit.

Për sa më lart, largimi im nga puna, ndërkohë që isha ende duke u gjykuar edhe si inspektor me 15 vite në detyrë dhe pa asnjë masë disiplinore, më duket i padrejtë dhe diskriminues”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe kthimin në vendin e punës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon ndër të tjera, zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me bindjet politike, pretenduar nga ankuesi, duke parashikuar në nenin 1 të tij se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS,

shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje që janë objekt i ankesës dhe që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 1144/1, datë 30.10.2023, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga subjekti, lidhur me pretendimet e subjektit ankues, si dhe ka kërkuar dokumentacionin si më poshtë:
 - Kopje të dosjes personale të ankuesit (vendim emërimi, kontrata pune, masa disiplinore, vlerësim performance për vitet 2020-2021, etj).
 - Kopje të plotë të procedurës së ndjekur lidhur me pezullimin dhe largimin nga detyra të ankuesit.
 - Informacion nëse ka punonjës të tjerë, të AKU (në kushte të njëjta apo të ngjashme me ankuesin) që janë pezulluar dhe larguar nga puna, gjatë periudhës nga data 01.11.2020 deri në datë 08.11.2021.
 - Kopje të Rekomandimeve të Raportit Përfundimtar të Ministrisë së Drejtësisë nr. 5823/1, datë 11.11.2021.
 - Kopje të Relacionit të Komisionit Disiplinor nr. 4225/3, datë 28.12.2021.

Me shkresën me nr. 5441/1, datë 09.11.2023, AKU, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “Ankuesi M.K ka filluar punë pranë AKU, në datë 01.07.2010, në pozicionin Inspektor pranë Drejtorisë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Qarku Fier (AKU Fier), sipas Urdhrit të emërimit nr. 139, datë 01.07.2010. Ndërmjet palëve është lidhur kontrata individuale e punës nr.

139/1, datë 01.07.2010, me afat deri në përfundimin e procedurave të rekrutimit. Me Urdhrin nr. 401/2, datë 02.12.2010 është emëruar në pozicionin Inspektor pranë Sektorit të Inspektimit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë dhe Operatorëve të Biznesit në AKU Fier. Ndërmjet palëve është lidhur kontrata individuale e punës në kohë prove me nr. 401/3, datë 02.12.2010 me afat 3 muaj. Me Urdhrin nr. 401/6, datë 01.06.2012 është emëruar në pozicionin Inspektor pranë Sektorit të Inspektimit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit në AKU Fier.

Me shkresën nr. 3267/101, datë 30.10.2014 të DAP është deklaruar Nëpunës Civil në pozicionin Inspektor pranë Sektorit të Inspektimit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo Shtazore dhe operatorëve të Biznesit në AKU Fier. Me hyrjen në fuqi të Ligjit 16/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për Ushqimin”, i ndryshuar, AKU ka dalë nga fusha e zbatimit të ligjit të shërbimit civil, marrëdhëniet e punës të të cilit rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.

Me Vendimin nr. 1459/7, datë 01.04.2020 është vendosur lirimi nga shërbimi civil për shkak të ligjit. Ndërmjet palëve është lidhur kontrata individuale e punës nr. 1474/3, datë 01.04.2020 me afat të pacaktuar, në pozicionin Inspektor pranë Sektorit të Inspektimit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit në AKU Fier.

Me Urdhrin nr. 4759, datë 05.11.2020, M.K është transferuar nga pozicioni Inspektor pranë Sektorit të Inspektimit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit në AKU Fier në pozicionin Inspektor në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë dhe OBU në AKU Fier.

Në datë 02.11.2021, AKU ka përcjellë për verifikim dhe ndjekje të mëtejshme Koordinatorit të Rrjetit Kundër Korrupsionit pranë AKU, denoncimin nga qytetari E.M, me nr. 3854, datë 02.11.2021.

Sipas ankesës së paraqitur, subjekti “E.M” me veprimtari “Tregti fruta-perime”, ndër të tjera, pretendon se i është kërkuar ryshfet nga dy inspektorë të AKU Fier në mënyrë që të mos ushtrohet kontrolli zyrtar, si dhe ngre pretendimin se, pasi nuk ka pranuar tu japë atyre ryshfet, ata kanë aplikuar gjobë në vlerën 400.000 lekë ndaj tij. Në mbështetje të pretendimeve të tij qytetari ka depozituar edhe një CD, e cila përmban filmime të datës 14.09.2021, nga kamera e brendshme e subjektit, në kohën e inspektimit.

Z. A.P, në cilësinë e Koordinatorit kundër Korrupsionit pranë AKU bazuar në kompetencat funksionale, pasi u njoh me ankimimin, së pari ka kërkuar dokumentacionin përkatës ku ka administruar edhe praktikën e inspektimit, të datave 14.09.2021 dhe 15.09.2021, inspektim i cili është kryer nga inspektorët M.K dhe D.S.

Koordinatori pranë AKU ka filluar hetimin administrativ mbi denoncimin e qytetarit E.M, me nr. 3854, datë 02.11.2021. Pas publikimit në media nga Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit, pranë Ministrisë së Drejtësisë, lidhur me hetimin administrativ të kryer nga

Koordinatori i Rrjetit Kundër Korrupsionit për AKU, për praktikën e inspektimit të kryer nga inspektorët e AKU Fier, në subjektin “E.M” është vendosur menjëherë “Pezullimi nga detyra” për inspektoret M.K dhe D.S.

Me Urdhrin nr. 4106, datë 09.11.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm është vendosur pezullimi nga detyra i M.K. Masa e pezullimit është marrë pas vlerësimit se ekzistojnë dyshimet e arsyeshme për punonjësin, për të cilin ka nisur ecuria disiplinore, që vazhdimi i ushtrimit të detyrës mund të cenojë ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së tij, në drejtim të moszbatimit të urdhrave dhe moskryerjes së inspektimeve.

Në përfundim të hetimit administrativ, Ministri i Drejtësisë në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit ka dërguar për zbatim pranë AKU, Raportin Përfundimtar me nr. 5823, datë 11.11.2021, me objekt “Hetim Administrativ”, në përfundim të të cilit është propozuar marrja e masës administrative “Largim nga detyra” për M.K dhe D.S dhe fillimin e ecurisë disiplinore ndaj Kryeinspektorit Rajonal Y. A.

AKU bazuar në këtë raport ka filluar ecurinë disiplinore ndaj M.K, D.S dhe Y.A.

Me Urdhrin nr. 4225, datë 17.11.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm është ngritur Komisioni Disiplinor bazuar në rekomandimet e Raportit Përfundimtar nr. 5823/1, datë 11.11.2021 të Ministrisë së Drejtësisë dhe ka njoftuar nëpunësin me shkresën nr. 4225/1, datë 17.11.2021 “Njoftim për bisedime lidhur me zgjidhjen e kontratës së punës” dhe aktet shoqëruese bashkëlidhur njoftimit.

Komisioni disiplinor ka dokumentuar mbledhjen e datës 23.11.2021, nëpërmjet procesverbalit të sekretariatit teknik nr. 4225/2, datë 23.11.2021. Sipas procesverbalit rezulton se nëpunësi nuk është paraqitur në takim dhe komisioni do të verifikojë shkaqet e mungesës së nëpunësit në procedim e sipër.

Në përmbajtje të relacionit nr. 4225/3, datë 28.12.2021 të Komisionit Disiplinor të AKU janë evidentuar shkelje të rënda disiplinore nga ana e inspektorit M.K, bazuar në konkludimet e raportit të Ministrisë së Drejtësisë.

Në përfundim të shqyrtimit të masës disiplinore dhe hetimit administrativ Komisioni i Disiplinës, pasi kreu një hetim të plotë lidhur me shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e ardhura prej saj, shkallën e fajësisë, vendosi ti propozojë Drejtorit të Përgjithshëm dhënien e masës disiplinore “Largim nga puna”, për M.K.

Me Urdhrin nr. 4766, datë 28.12.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm është marrë masa disiplinore “Largim nga detyra” për M. K për shkelje të rënda disiplinore.

Shkeljet e rënda disiplinore të kryera nga punëmarrësi lidhen me “mos përmbushjen e detyrave funksionale” dhe “moszbatimin haptazi të dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave

funkcionale”, parashikuar nga neni 16/5, germa “a” dhe “c” i kontratës individuale të punës të cilat kanë sjellë pasoja shumë të rënda në aspektin e cenimit të sigurisë ushqimore.

Marrëdhëniet e punës dhe financiare janë ndërprerë në datë 29.12.2021, si dhe është vendosur t'i paguhen ditët e pushimeve vjetore të pashfrytëzuara për vitin 2021.

Në përmbajtje të Raportit Përfundimtar nr. 5823/1, datë 11.11.2021 të Ministrit të Drejtësisë me objekt “Hetim Administrativ”, rezulton se:

“Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe pamjeve filmike, në datë 05.11.2021, Koordinatori i Rrjetit ka hartuar dhe përcjellë për kundërshtime pranë AKU Fier, akt-konstatimet dhe gjetjet përkatëse.

Në datë 09.11.2021, M.K dhe D.S kanë përcjellë pranë Koordinatorit kundër Korrupsionit AKU kundërshtimet mbi këto akt-konstatime. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, pamjeve filmike dhe kundërshtimeve të administruara për këtë hetim, struktura përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë konstaton dhe arsyeton si vijon:

- Nga shqyrtimi i pamjeve filmike rezulton se në asnjë moment personat në ambientet e subjektit nuk identifikohen si inspektorë të AKU.*

Veprim ky në kundërshtim me pikën 4, të nenit 30, të ligjit 10433/2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ku citohet se: “Gjatë ushtrimit të veprimtarisë inspektuese, inspektori identifikohet me kartën e inspektorit”.

Në pikën 5.4 tek Kodi i Etikës “Për punonjësit e inspektorateve shtetërore në Republikën e Shqipërisë” thuhet se: “... Gjatë ushtrimit të detyrës punonjësit e inspektorateve shtetërore duhet të mbajnë në mënyrë të ekspozuar kartën e inspektorit ose kartën e punonjësit”. Ndërkohë që në materialin filmik prej 19 minutash e 30 sekondash, kohë kjo në ushtrimin e detyrës, nuk vihet re asnjë kartë identifikuese e inspektorëve.

Në lidhje me konstatimin e sipërcituar, inspektorët M.K dhe D.S nuk kanë paraqitur asnjë kundërshtim.

- Nga shqyrtimi pamjeve filmike rezulton se, inspektori M.K rri gjithë kohës në telefon, madje ndez dhe cigare në ambientet e brendshme të subjektit.*

Veprim ky në kundërshtim me germën “d”, të nenit 15, të ligjit 9636/2006 “Për Mbrojtjen e Shëndetit nga Produktet e Duhanit”, ku parashikohet se: “Ndalohet pirja e duhanit: d) mjedise tregtare, bare, restorante, diskoteka dhe klubet e natës”.

Në lidhje me konstatimin e sipërcituar, inspektorët M.K dhe D.S kanë paraqitur kundërshtimet e tyre duke cituar se: “Pirja e cigares mund të ketë qenë e pavetëdijshme nga inspektori në një situatë tensioni”.

- Nga shqyrtimi i pamjeve filmike dhe praktikës së inspektimit rezulton se, nga inspektorët nuk kemi pasqyrim të gjendjes reale në praktikën e inspektimit të mbajtur me datë 14.09.2021, pasi aty citohet se “Bazuar në pikën 3, të nenit 29, të ligjit 10433/2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, kërkohet shtyrje e kohëzgjatjes së inspektimit se me datë 14.09.2021 nuk ishte prezent personi përgjegjës e për pasojë ishte e pamundur verifikimi i dokumentacionit”.

Ndërkohë, nga pamjet filmike rezulton se personi përgjegjës është aty, madje në ndihmë të tij vjen dhe një zonjë e cila vë në dispozicion disa fatura. Njëkohësisht, ankuesi pretendon që nuk i është vënë në dispozicion asnjë dokumentacion për të firmosur, ndërkohë praktika e inspektimit rezulton e refuzuar.

Në nenin 41, germa 9, të ligjit për inspektimin, citohet se: “Të kryejë verifikime të dokumenteve për identitetin e personave, kur kjo është e nevojshme, sipas objektit të inspektimit”.

Në pikën 1, të nenit 39, të ligjit për inspektimin, citohet se: “Gjatë inspektimit, inspektori ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë kopje të dokumenteve të veprimtarisë, në përputhje me objektin e inspektimit. Kërkesa bëhet me gojë dhe pasqyrohet në procesverbalin e inspektimit. Çdo kopje dokumenti i marrë, nënshkruhet nga përfaqësuesi i subjektit të inspektuar”.

Në pikën 1, të nenit 70 (Procedurat e kundërvajtjes, shkeljes) të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për Ushqimin”, citohet se: “Inspektori i AKU shqyrton shkeljet, sipas këtij ligji, dhe merr vendim përfundimtar aty për aty. Vendimi përfundimtar është pjesë e procesverbalit dhe mbahet në vendin e inspektimit dhe i njoftohet, pa vonesë, subjektit të inspektimit ...”.

Në lidhje me konstatimin e sipërcituar, inspektorët M.K dhe D.S nëpërmjet kundërshtimeve të tyre pretendojnë se: “Pasi janë paraqitur në subjekt zotëria që ndodhej aty është prezantuar si shitës dhe se E.M ndodhej jashtë qytetit.

Gjithashtu, kemi kërkuar dokumentacionin përkatës por nuk na u vu në dispozicion pasi zonja që erdhi në subjekt paraqiti vetëm fatura të pagesave të sigurimeve shoqërore dhe taksa të ndryshme dhe nuk u paraqit asnjë dokument në lidhje me produktet ushqimore”.

- Në lidhje me kundërshtimet e inspektorëve sqarojmë se, në praktikën e inspektimit, rezulton se me datë 14.09.2021 inspektorët M.K dhe D.S janë autorizuar dhe kanë ushtruar kontroll pranë subjektit E.M, pasi kjo verifikohet nëpërmjet pamjeve filmike.

Ndërkohë që me kërkesën nr. AKU-FR-2021-002271-9, datë 14.09.2021, inspektorët M.K dhe D.S, kanë bërë kërkesë për shtyrje të autorizimit të inspektimit me pretendimin se “Mungon personi përgjegjës dhe për këtë arsye nuk është i mundur verifikimi i dokumentacionit”, ndërkohë që siç kemi sqaruar dhe në paragrafin e mësipërm në pamjet filmike të vëna në dispozicion nga vetë subjekti i kontrollit rezulton se inspektorët kanë qenë pranë subjektit në datën 14.09.2021 dhe kanë takuar dhe biseduar (ushtruar kontroll) mbi subjektin e kontrollit E.M.

Prania e E.M gjatë kontrollit konfirmohet nga pamjet filmike, si dhe është verifikuar dhe nëpërmjet Koordinatorit kundër Korrupsionit pranë Gjendjes Civile, i cili me e-mailin e datës 04.11.2021 konfirmon që personi në pamjet filmike është pikërisht E.M. Për më tepër, që inspektorët kanë detyrim të kërkojnë mjete identifikimi për personat që ndodhen në subjekt.

Ndërkohë, autorizimi për kontroll është shtyrë për datën 15.09.2021 dhe inspektorët sipas ankuesit janë paraqitur pranë subjektit, por nuk i kanë vënë në dispozicion asnjë shkresë.

Në vijim të këtij kontrolli është mbajtur procesverbali i inspektimit datë 15.09.2021, me të cilin janë vendosur gjoha në shumën totale 400.000 (katërqind mijë) lekë, ndërkohë që te pjesa e procesverbalit ku duhet të nënshkruante subjekti i gjobitur, është vënë shënimi “Refuzon”.

Së fundmi, nga tërësia e veprimeve dhe mosveprimeve të inspektorëve konstatojmë që në akt-inspektimet e datës 14.09.2021 dhe 15.09.2021, janë pasqyruar fakte të rreme.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi inspektorët M.K dhe D.S për veprimet dhe mosveprimet e përcaktuara në dispozitat e lartpërmendura si dhe paraqitjen e fakteve të rreme në procesverbalin e konstatimeve.

Në lidhje me vonesën në Vendimin e Marrjes së Masës Urgjente, Inspektorët justifikohen se nuk ishte personi përgjegjës. Nëse kemi të bëjmë me një rast të tillë, pavarësisht pretendimeve se nuk ndodhet personi përgjegjës, nuk mund të shtyhej me një ditë Vendimi për Marrjen e Masës Urgjente.

- Ndërkohë vlerësojmë se, bazuar në pikën 13, të VKM nr. 708, datë 09.09.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e AKU” ku citohet se: “Kryeinspektori rajonal përgjigjet te Drejtori i Përgjithshëm i AKU-së dhe është përgjegjës për cilësinë, integritetin dhe efektivitetin e veprimtarisë inspektuese të drejtorisë rajonale dhe të stafit të saj, si dhe e përfaqëson atë me të tretët, në nivelin e qarkut përkatës”, vlerësojmë se:

“Në kuptim të dispozitës së sipërcituar, është detyrim dhe përgjegjësi e Kryeinspektorit Rajonal, që të kontrollojë dhe të përgjigjet mbi veprimtarinë inspektuese të AKU Fier, në kuadër të cilësisë, efektivitetit dhe integritetit.

Për sa më sipër, në të gjithë situatën e parashtruar më sipër, mban përgjegjësi edhe titullari i AKU Fier, Y.A, pasi veprimet dhe mosveprimet e inspektorëve kanë ndikuar në cilësinë, efektivitetin dhe integritetin e veprimtarisë inspektuese dhe në veçanti kanë cenuar imazhin e AKU.

Sa më sipër, në bazë të pikës 15, të kreut V, të VKM nr. 618, datë 20.10.2021 “Për krijimin, organizimin e funksionimin e rrjetit të koordinatorëve kundër korrupsionit”, duke pasur në konsideratë, natyrën e shkeljeve, rolin e personave në këtë inspektim dhe pasojat që kanë sjellë këto shkelje në përmbushjen e qëllimit të sigurisë ushqimore është propozuar marrja e masës

disiplinore “largim nga detyra” për inspektorët M.K dhe D.S dhe fillimin e ecurisë disiplinore për kryeinspektorin Y.A”.

Lidhur me Vendimin nr. 51, datë 23.03.2023 të Komisionit të Shqyrtimit të Masave Administrative i ngritur pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural argumentojmë se komisioni ka vlerësuar ekzistencën e shkeljeve të kërkesave ligjore të kryera nga e subjektit duke vlerësuar lënien në fuqi të masës së gjobës.

Theksojmë se, si në raportin përfundimtar të Ministrit të Drejtësisë ashtu edhe në relacionin e Komisionit Disiplinor nuk është argumentuar në asnjë rrethanë mungesa e shkeljeve nga ana e subjektit (E.M) të cilat ekzistojnë dhe ishin reale, por kanë vënë në dukje mos përmbushjen e rregullt të detyrave, moszbatimin e dispozitave ligjore dhe mos administrimin e një procesi të rregullt e formal të procedurës së inspektimit nga ana e inspektorëve duke neglizhuar detyrën.

“Mos përmbushja e detyrës” dhe “mosrespektimi haptazi i dispozitave ligjore në përmbushjen e detyrave funksionale”, evidentohen edhe nga Procesverbali “Për kqyrjen e pamjeve filmike”, mbajtur nga znj. A.V me detyrë Oficer i Policisë Gjqësore pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Fier si dhe Vendimi nr. 62-2022-1322 (208), datë 07.04.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjqësor Fier.

Bazuar në pamjet filmike rezulton hyrja-dalja e shpeshtë në ambientet e subjektit E.M, komunikimi me telefon nga ana e inspektorit M.K.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier me Vendimin nr. 62-2023-2261 (278), datë 08.06.2023 ka vendosur: “Pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit M.K për kryerjen e veprës penale të “Korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike ... sipas nenit 259 të Kodit Penal, pasi gjykata në rastin konkret ka arritur në përfundimin që çështja penale në ngarkim të të pandehurit M.K bazuar në nenin 328/1, germa “dh” dhe germa “f” të KPP duhet të pushohet pasi nuk u arrit të provohet kryerja e veprës penale prej tyre.

Për sa më lart çmojmë të vëmë në dukje se përgjegjësia penale është e ndryshme nga përgjegjësia administrative, e cila manifestohet në këtë rast nëpërmjet mospërmbushjes së detyrave dhe moszbatimit haptazi të ligjit.

Vendimi mbi pushimin e çështjes penale për arsye se nuk provohet kryerja e veprës penale të “Korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike”, nuk e çliron ankuesin nga përgjegjësia administrative si rrjedhojë e shkeljeve disiplinore sipas përcaktimeve në kodin e punës, rregulloren e institucionit dhe kontratën e punës.

Në kundërshtim me sa pretendon ankuesi theksojmë se AKU ka zhvilluar një proces të rregullt ligjor në përputhje me normat, parimet dhe rregullat e parashikuara nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 37 dhe 144/1 i Kodit të Punës.

Theksojmë se e njëjta procedurë është ndjekur dhe zbatuar dhe ndaj inspektores D.S, lidhur me zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës, me Urdhrin nr. 4767, datë 28.12.2021.

Gjithashtu dhe ndaj Y.A bazuar në Raportin Përfundimtar nr. 5823/1, datë 11.11.2021 të Ministrit të Drejtësisë dhe Relacionit nr. 4227/3, datë 30.12.2021 të Komisionit Disiplinor të AKU është dhënë nga titullari masa disiplinore “Vërejtje” me Urdhrin nr. 35, datë 06.01.2022, për shkelje disiplinore të “Mospërmbushje së detyrave”.

Në rastin në shqyrtim duke vlerësuar rëndësinë që ka siguria ushqimore në jetën dhe shëndetin e qytetarëve gjykohet se, kur nëpunësit që kanë për detyrë inspektimin e subjekteve që tregtojnë mallra ushqimore, shkelin legjislacionin në fuqi dhe favorizojnë paligjshmërinë e subjekteve, duke lënë kështu vend për ardhjen e pasojave shumë të rënda për publikun, përbën domosdoshmëri marrja e masave disiplinore në proporcion me shkeljet e kryera, me qëllim zbatimin me rigorozitet të legjislacionin në fushën e sigurisë ushqimore.

Në vazhdimësi, Ministria e Drejtësisë nëpërmjet Koordinatorit të Rrjetit kundër Korrupsionit pranë AKU dhe me shkresën nr. 5823/3, datë 15.12.2021 ka kërkuar informacion “Mbi marrjen e masave në kuadër të përfundimit të hetimit administrativ” për largimin nga detyra të dy inspektorëve dhe fillimin e ecuresë disiplinore për kryeinspektorin.

Për sa më lart, vlerësojmë se procedura e ndjekur dhe vendimmarrja nga AKU rezulton e marrë në përfundim të një procesi të rregullt ligjor”.

Në përgjigje të parashtrimeve të AKU, ankuesi me e-mail-in datë 19.11.2023, parashtoi se: “Unë jam njoftuar në lidhje me një hetim që po kryhej nga Koordinatori i Rrjetit kundër Korrupsionit ndaj meje, nëpërmjet e-mail-it zyrtar nga Drejtori Rajonal i AKU Fier, ditën e hënë, në datën 08.09.2021 dhe ditën e martë datë 09.11.2021, në mëngjes, kur ne ishim duke dërguar sqarimet lidhur me çështjen, po në atë moment, në televizion ka folur Ministri i Drejtësisë duke kërkuar në mënyrë publike marrjen e masave kundër inspektorëve pa marrë parasysh sqarimet tona si trupë inspektuese dhe po atë ditë është bërë edhe pezullimi ynë nga puna, të cilat janë lehtësisht të verifikueshme nga e-mail-et zyrtare.

Mosparaqitja ime në datën 23.11.2021 në Komisionin Disiplinor të njoftuar në datën 17.11.2021 nuk ka të bëjë me neglizhencën time apo mosdashjen time, por ka të bëjë me pamundësinë time sepse ndaj meje është marrë masa “Arrest me burg” në datën 22.11.2021 dhe për inspektorin tjetër është marrë masa “Detyrim paraqitje”.

Pamjet filmike nuk i përkasin datës 14.09.2021 por datës 15.09.2021 e cila është edhe dita e dytë e inspektimit. Kjo vërtetohet nga thëniet e E.M gjatë fazës së hetimit kur thotë që DVR-ja që ai disponon, ka kapacitet të vogël dhe nuk mundëson pamje të dyja ditëve të inspektimit dhe gjithashtu edhe prania e një inspektori tjetër, i cili ka nuk ka qenë pjesë e këtij inspektimi dhe ka qenë prezent vetëm në datën 15.09.2021, pasi ishte pjesë e inspektimit tjetër që do të zhvillohej po në këtë datë.

Në ditën e parë të inspektimit E.M ka mohuar që të jetë pronari i subjektit së bashku me zonjën që ishte aty dhe nuk mund të paraqiste asnjë lloj dokumentacioni pasi pronari ndodhej jashtë qytetit duke na thënë se ditën e nesërme do të mund vinte vetë pronari dhe të na vinte në dispozicion dokumentacionin e kërkuar. Ne nuk kemi asnjë tagër që të mund t'u kërkojmë gjatë inspektimit asnjë mjet identifikimi personave që drejtojnë këto subjekte. Në zbatim të nenit 40 të gjitha pikat, nenit 41 të gjitha pikat të ligjit 9863 datë 28.01.2008 "Për ushqimin", i ndryshuar, që janë përkatësisht parimet e përgjithshme të kontrollit të ushqimit dhe objekti i kontrollit zyrtar të ushqimeve si edhe neni 43, masat e përgjithshme të administrimit të kontrollit zyrtar të ushqimeve të gjitha pikat, inspektori nuk ka detyrim të kërkojë dokumente identifikimi.

Zonja që ishte prezent gjatë inspektimit (ishte bashkëjetuesja e E.M) në momentin që duhej të jepte dëshminë në gjykatë ka refuzuar të dëshmojë, ka hedhur në mënyrë demonstrative urdhrin e ekzekutimit të Përmbarrimit për vjeljen e gjobës duke thënë se "...ju më dhatë fjalën që unë nuk do të paguaj gjobën". Se kujt iu drejtua unë nuk e di.

Subjekti E.M është kontrolluar pas denoncimit të ardhur në info@aku.gov.al për herë të parë nga trupa inspektuese në fjalë, nga informacionet që unë kam nuk është rikontrolluar më dhe vazhdon të kryejë qetësisht të njëjtat shkelje ligjore për të cilat është gjobitur dhe ka paguar edhe gjobën dhe e gjitha kjo mua nuk më duket e drejtë për të gjitha këto që unë kam kaluar këto dy vjet për shkak të këtij subjekti.

Në pamjet filmike unë paraqitem me bluzë ngjyrë blu dhe nga bluza duket qartë rripi i kuq i mjetit të identifikimit të cilin e vendosja për çdo ditë në orën 8:00 dhe e hiqja në fund të ditës së punës.

Përsa i përket konsumimit të cigares në ambientet e brendshme të subjektit të E.M nuk është e vërtetë edhe kjo vërtetohet lehtësisht në pamjet filmike ku unë paraqitem duke nxjerrë një cigare në momentin e largimit nga subjekti, saktësisht duke kaluar pragun e tij për të dalë jashtë dhe nuk e kam ndezur për asnjë çast brenda ambienteve të tij. Këto pamje filmike janë administruar dhe përdorur gjatë procesit hetimor dhe gjyqësor dhe nuk janë marrë në konsideratë nga Gjykata duke qenë se nuk vërtetonin asnjë nga pretendimet e Koordinatorit të Rrjetit Kundër Korrupsionit, gjithashtu vetë subjekti E.M ka mohuar të gjitha pretendimet e ngritura në padinë kundër personit tim.

Përsa i përket përdorimit të telefonit gjatë këtij inspektimit, e gjithë koha për të cilën unë akuzohem se kam ndenjur duke komunikuar në telefon, ka qenë me kryeinspektorin lidhur me inspektimin në fjalë të cilën e vërteton edhe tabulati telefonik. Gjithashtu theksoj se aparati telefonik, minutat telefonike dhe internet janë të miat personale dhe unë i kam vënë në dispozicion të inspektimeve duke qenë se tabletët me të cilat ne operojmë nuk kanë internet dhe ne duhet tu japim internet nga celularët tanë. Celulari është pjesë e domosdoshme e punës dhe gjatë pamjeve filmike nuk paraqitem në asnjë moment duke folur në telefon dhe koha për të cilën akuzohem nuk është e matshme por vetëm thënie të subjektit të cilat nuk janë të konfirmueshme dhe pamjet filmike janë pjesëza dhe jo një filmim linear.

Procedura e inspektimit kryhet on-line në sistemin e-inspektive. Portali e-inspektive është ndërtuar i tillë që ka një hierarki dokumentesh që domethënë, nëse nuk gjenerohet lista e verifikimit nuk ke mundësi të ndërtosh proces verbal, vendim përfundimtar, asnjë dokumentacion tjetër dhe për këtë është e pamundur që ne të mund të ndërtonim dhe të gjeneronim proces verbal në datën 14.09.2021 dhe listë verifikimi në datë 15.09.2021. Ndërtuesi i këtij materiali ose nuk e njeh sistemin ose e bën qëllimisht. Çdo veprim i kryer nga trupa inspektuese në datat 14 dhe 15 nëntor 2021 është lehtësisht i verifikueshëm nga IT-të e Inspektoratit Qendror, data, ora dhe vendndodhja.

Përsa i përket marrjes së masës urgjente duke parë që natyra e aktivitetit dhe madhësia e biznesit konsiderohet me risk të ulët, nga ne është bërë interpretimi i frymës së ligjit nr. 10433, neni 43, në pikat 4 dhe 5. Masa urgjente është marrë për ushtrim të aktivitetit në kundërshtim me Udhëzimin nr. 22, datë 25.11.2010, Shtojca II, Kapitulli IX, pika 4 “Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor”.

Gjithashtu sistemi i e-inspektimit nuk të lejon të kryesh një pezullim pa afat por je i detyruar të vendosësh datë fillimi dhe mbarimi. Kjo mënyrë operimi nuk është kontestuar asnjëherë edhe gjatë auditimeve periodike të kryera. Kjo praktikë është përdorur nga të gjithë inspektorët kur vendosen masa urgjente pa afat.

Në rast se do të vendoseshin data siç na detyron sistemi i inspektimit do të rrezikonin të parashkruheshin të gjitha masat urgjente pa u zbatuar vendimet e marra nga trupa inspektuese sipas përcaktimit të ligjit nr. 10433/2011, neni 43, pika 6 të ligjit “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 63, datë 11.01.2024 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 23.01.2024, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces, si dhe kërkoi kopje të dokumentacionit si më poshtë:
 - Informacion nëse ka punonjës të tjerë, të AKU (në kushte të njëjta apo të ngjashme me ankuesin) që janë pezulluar dhe larguar nga puna, gjatë periudhës nga data 01.11.2019 deri në datë 08.11.2021.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Seanca u zhvillua në datë 23.01.2024, me praninë e palëve në proces: subjekti ankues, M.K dhe përfaqësuesve me autorizim² të AKU-së znj. A.H dhe znj. J.L.

² Autorizim nr. 309, datë 22.01.2024 të AKU.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi i qëndroi parashtimeve të bëra gjatë komunikimit shkresor dhe me e-mail me Komisionerin dhe në mes të tjerash deklaroi se: *“Gjatë inspektimit kam komunikuar me drejtorin rajonal dhe i shpjegova gjendjen dhe në dakordësi me drejtorin, shtymë autorizimin me 24 orë. Të nesërmen subjekti nuk solli dokumentacionin e kërkuar dhe morëm masë me gjobë të cilën subjekti refuzoi ta firmosë. Më pas më vjen një njoftim nga dikush nga Ministria e Drejtësisë që punonte pranë AKU dhe pa prituri përgjigje për raportin më vjen pezullimi nga puna, thirrja në polici dhe tre ditë më pas më vjen arresti. Për pezullimin nga puna u njoftova me e-mail dhe me shkresë nga sekretarja. Unë nuk kisha kohë që të bëja diçka sepse përfundova në arrest me burg për tre javë dhe një vit e gjysëm arrest shtëpie. Nuk kisha emergjencë për të kundërshtuar urdhrin e pezullimit dhe komisionin disiplinor sepse kisha halle të tjera (procesi penal). Inspektorja tjetër është paraqitur në komisionin disiplinor, pasi ishte në masë detyrim paraqitje. Përsa kohë ishte drejtor i përgjithshëm z. S, ishte thënë se ju jeni në rregull nga ana e dokumentacionit. Sapo erdhi në detyrë drejtorja e re, puna e parë që ka bërë është që më ka shkarkuar nga detyra. Nga ana e AKU nuk është bërë asnjë veprim për të hetuar shkeljet e inspektimit, pasi të gjitha veprimet janë kryer nga inspektori i Ministrisë së Drejtësisë”.*

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesit e AKU dorëzuan parashtime me shkrim nr. 309/1, datë 23.01.2024, në të cilën informonin se: *“Lidhur me informacionin nëse ka punonjës të tjerë të AKU që janë pezulluar dhe larguar nga puna, gjatë periudhës nga data 01.11.2019 deri në datë 08.11.2021, ju informojmë si vijon:*

Siç ju kemi informuar, e njëjta procedurë është ndjekur dhe zbatuar dhe ndaj inspektores tjetër D.S me pozicion Inspektor në DR AKU Fier, lidhur me procedurën e inspektimit në praktikën e subjektit “E.M”, duke ndërmarrë të njëjtat veprime si: Pezullimi nga detyra; Njoftim për bisedime; Urdhër për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës për D.S.

*Rast i ngjashëm me ankuesin brenda periudhës së kufizuar nga shkresa juaj përbën edhe procedura e ndjekur dhe zbatuar ndaj z. E.Sh, Inspektor i Drejtorisë Rajone të AKU Qarku Fier lidhur me procedurën e inspektimit në praktikën e subjektit “Agronom Geoponus”. Referuar pamjeve filmike të shfaqura nga emisioni investigativ STOP, evidentohet se inspektori E.Sh nuk ka qenë i pranishëm në një procedurë inspektimi dhe ka nënshkruar më pas procesverbalin dhe vendimin e inspektimit. Procedura disiplinore ndaj z. E.Sh ka filluar me ngritjen e komisionit disiplinor dhe me vendimin e ndërmjetëm të komisionit disiplinor është pezulluar nëpunësi deri në marrjen e vendimit përfundimtar. Në përfundim të shqyrtimit të masës disiplinore dhe hetimit administrativ Komisioni i Disiplinës ka vendosur “Largim nga shërbimi civil” për nëpunësin civil z. E.Sh, me detyrë Inspektor”, dhe gjatë seancës në mes të tjerash deklaruan³ se: *“Në faqen web është paraqitur ankesë nga subjekti E.M. Së bashku me ankimin subjekti ka paraqitur dhe një CD, ku jep momente inspektimi të datës 14.09.2021, në të cilën subjekti pretendonte për veprime korruptive. Pranë institucionit ndodhet koordinatori antikorrupsion, i cili propozohet nga Ministria e Drejtësisë dhe ka varësi nga ato, pavarësisht se kontratën e punës e ka me AKU. Nga verifikimi i praktikës dhe nga hetimi administrativ që ka bërë koordinatori**

³ Referuar deklarimeve të bëra gjatë seancës dëgjimore, min 28.50 e në vijim.

antikorrupsion rezulton se në datë 14.09.2021, subjekti tregtonte kafshë dhe produkte ushqimore, i cili ishte në kushte të rënda higjeno-sanitare dhe inspektori që ka përvojë dhe që është i pavarur në vendimmarrjen e tij, nuk ka pse konsultohet apo në vendimmarrjen e tij të ndikohet nga drejtori rajonal. Pamjet filmike tregojnë se inspektori nuk ka qenë i pajisur me kartë inspektori (bagde), ka konsumuar cigare në subjekt, ka kryer telefonata, ka hyrje-dalje në subjekt dhe kanë verifikuar dokumentacionin që ishte në subjekt. Inspektori nuk ka shtyrë inspektimin se gjoba ishte e madhe por justifikimi që kanë përdorur për shtyrjen e inspektimit ka qenë se nuk bëhej i mundur identifikimi i subjektit që ishte në subjekt. Ligji i jep të drejtën inspektorëve të AKU për të bërë identifikimin e personit, pra mund të kërkonin kartë identiteti, pasi subjekti ishte person fizik dhe e kishte në emrin e tij. Kushtet higjeno-sanitare tek ky subjekt kanë qenë të rënda, pra dhe masa urgjente që duhej të merrej, sidomos nga një inspektor me eksperiencë duhej të ishte pezullimi i aktivitetit. Në datë 15.09.2021, AKU nuk ka dijeni se si është bërë i mundur identifikimi i subjektit, dmth një ditë më pas kanë arritur të identifikojnë subjektin E.M. Të gjitha këto veprime kanë krijuar dyshime tek koordinatori por dhe te institucioni, ku ka pasur thyerje besimi sepse nuk kemi dokumentacion për veprime korruptive. Koordinatori antikorrupsion ka vënë në dijeni grupin e hetimit për veprimet dhe ka kërkuar shpjegime. Komisioni i shqyrtimit të gjobave në Ministrinë e Bujqësisë nuk ka pretenduar se nuk ka shkelje nga subjekti E.M, prandaj dhe gjoba është lënë në fuqi. Ministria e Drejtësisë ka dërguar rekomandim që propozonte masë disiplinore “Largim nga puna” për inspektorët dhe fillimin e procedurave disiplinore për drejtorin rajonal. Ankuesi është vënë në dijeni nga koordinatori antikorrupsion për nisjen e hetimit. Drejtoria e përgjithshme e AKU-së, komunikimet i mban me drejtorinë rajonale dhe ankuesin dhe nuk na ka ardhur asnjë informacion për arsyet e mosparaqitjes së ankuesit në komisionin disiplinor. Nga ana e AKU-së nuk shikohen shkelje apo diskriminim, pasi dhe vetë ankuesi nuk paraqet saktë se cilat janë veprimet apo mosveprimet e institucionit që janë diskriminuese. Në çdo moment si nga koordinatori por dhe nga komisioni disiplinor që është ngritur, i janë vënë në dispozicion informacioni, arsyet dhe shkaqet dhe ka dhënë qëndrimet e tija dhe ka pranuar pirjen e duhanit, veprimet me telefon dhe ka thënë se këto kanë qenë për shkak të një një situate tensioni dhe stresuese. Shkelje e rëndë është, mosmarrja e menjëhershme e masave ndaj një subjekti, i cili operonte në fushën e ushqimit në kushte të rënda higjeno-sanitare”.

Në vijim të seancës dëgjimore, ankuesi me e-mail-in datë 28.01.2024, dërgoi kopje të Akt-Konstatimit datë 05.11.2021 të bërë nga koordinatori i rrjetit kundër korrupsionit dhe përgjigjen e trupës së inspektimit, datë 09.11.2021.

Në vijim të seancës dëgjimore, AKU me e-mailin datë 07.02.2024, informoi se M.K nuk ka pasur masë disiplinore të mëparshme në fuqi në kohën e largimit nga detyra dhe pas daljes nga shërbimi civil në prill 2020, deri në datën e largimit të ankuesit, nuk është kryer vlerësimi i punës për të.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 sipërcituar dhe nenin 3/1, parashikojnë se: “‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar

në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i ndryshuar, në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij”.*

Në Kreun II, të këtij ligji, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 12/1/c, ku përcaktohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ... c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.”*, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, bazuar në gjini, që i bëhet një punëmarrësi në gëzimin e të drejtës për punësim, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të disfavorshëm.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit, rezulton se:

Me Urdhrin nr. 139, datë 01.07.2010, M.K është emëruar në pozicionin Inspektor i Pikave të Kontrollit Kufitar, në Drejtorinë Rajonale të AKU, Qarku Fier dhe mes palëve është lidhur kontrata individuale e punës me afat deri në përfundimin e procedurave të rekrutimit.

Me Urdhrin nr. 401/6, datë 01.06.2012, është emëruar në pozicionin Inspektor në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit në AKU Fier.

Me shkresën nr. 3267/101, datë 30.10.2014 të DAP është deklaruar Nëpunës Civil në pozicionin Inspektor në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit në DR AKU Fier.

Me Vendimin nr. 1459/7, datë 01.04.2020 është vendosur lirimi nga shërbimi civil për shkak të ligjit⁴. Ndërmjet palëve është lidhur kontrata individuale e punës nr. 1474/3, datë 01.04.2020 me afat të pacaktuar, në pozicionin Inspektor në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit në DR AKU Fier.

Me Urdhrin nr. 4759, datë 05.11.2020, M.K është transferuar nga pozicioni Inspektor në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit në DR AKU Fier në pozicionin Inspektor në Sektorin e Kontrollit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë dhe OBU në DR AKU Fier.

Me shkresën datë 19.10.2021, drejtuar AKU, subjekti E.M është ankuar pranë këtij institucioni, lidhur me inspektimin e kryer nga ana e trupës së inspektimit të DR AKU Fier, në të cilin në mes të tjerash ka akuzuar grupin e inspektimit se i kanë kërkuar ryshfet për mosbërjen e kontrollit dhe pasi nuk ka pranuar tu japë ryshfet, ata kanë aplikuar gjobë në vlerën 400.000 lekë.

AKU në datë 02.11.2021 ka përcjellë për verifikim dhe ndjekje të mëtejshme, ankesën e bërë nga subjekti E.M, Koordinatorit të Rrjetit Kundër Korrupsionit pranë AKU.

Me e-mail-in datë 05.11.2021, A.P në cilësinë e Koordinatorit kundër Korrupsionit pranë AKU ka dërguar pranë DR AKU Fier, Akt-Konstatimin, pas verifikimit të ankesës së E.M.

Në aktin e konstatimit datë 05.11.2021, Koordinator kundër Korrupsionit ka konstatuar se: *“Nga kqyrja e materialit filmik dhe praktikës së inspektimit konstatojmë se: Së pari, është shkelur Kodi i Etikës pasi në asnjë moment personat nuk identifikohen si inspektorë të AKU. Për më tepër, inspektori M.K rri gjithë kohës në telefon, madje ndez dhe cigare në ambientet e brendshme të subjektit. Së dyti, është shkelur Parimi i Proporcionalitetit pasi gjoba e aplikuar ndaj subjektit është maksimale, krahasuar dhe me rrezikshmërinë e objektit të tregtimit të këtij subjekti. Aq më tepër që ky subjekt, pavarësisht se ushtron veprimtari që prej vitit 2015, është hera e parë që kontrollohet nga AKU Fier. Së treti, nga inspektorët nuk kemi pasqyrim të gjendjes reale në praktikën e inspektimit, pasi aty thuhet se me datë 14.09.2021 nuk ishte prezent personi përgjegjës e për pasojë ishte i pamundur verifikimi i dokumentacionit. Ndërkohë nga pamjet filmike, konstatoj se personi përgjegjës është aty, madje në ndihmë të tij vjen dhe një zonjë e cila vë në dispozicion disa fatura. Gjithashtu, ankuesi pretendon që nuk i është vënë në dispozicion asnjë dokumentacion*

⁴ Me hyrjen në fuqi të Ligjit 16/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për Ushqimin”, i ndryshuar, AKU ka dalë nga fusha e zbatimit të ligjit të shërbimit civil, marrëdhëniet e punës të të cilit rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.

për të firmosur, ndërkohë praktika e inspektimit rezulton e refuzuar. Së fundmi, kemi shpërdorim detyre nga ana e inspektorëve, me marrjen e masës urgjente me datë 15.09.2021, pra një ditë me vonesë nga momenti i inspektimit. Dimë që vendimi për marrjen e masës urgjente vjen kur kemi të bëjmë me një dëm që mund të shkaktohet në mënyrë të menjëhershme”.

Në përgjigje të akt konstatimit, M.K dhe D.S, me shkresën datë 09.11.2021, drejtuar drejtuesve të AKU dhe Koordinatorit të Rrjetit kundër Korrupsionit, në mes të tjerash kanë informuar se: “Në datën 14.09.2021 trupa inspektuese pasi u prezantua dhe shpjegoi arsyen pse ndodheshin aty, kërkoi personin përgjegjës për subjektin E.M, pasi zotëria që ndodhej në subjekt u prezantua si shitës nga i cili na u komunikua se E.M ndodhej jashtë qytetit. Inspektorët kanë kërkuar dokumentacionin e nevojshëm dhe zotëria “shitësi”, pretendoi se administratori E.M, kthehet nesër dhe dokumentet i ka ai..... Pas komunikimit me kryeinspektorin, duke qenë se ai ishte një rast denoncimi dhe gjatë inspektimit duhet të jetë prezent personi përgjegjës për të dhënë sqarimet e duhura dhe për të servitur dokumentacionin e nevojshëm u vendos të shtyhej autorizimi i inspektimit për ditën e nesërme, me datë 15.09.2021. Në datën 15.09.2021, inspektorët e AKU shkojnë sërish në subjekt për të vazhduar procedurën e inspektimit në prani të E.M dhe për të parë dokumentet të cilat ishin kërkuar një ditë më parë por konstatojnë se zotëria që një ditë më parë ishte prezantuar si “shitësi” ishte vetë E.M dhe zonja ishte bashkëshortja e tij, të cilët në momentin që inspektorët hyjnë në subjekt shfaqin shenja nervozizmi duke ngritur zërin për bezdinë nga kthimi për verifikim.

Përmbledhje: Së pari, trupa inspektuese është prezantuar si Inspektorë të AKU dhe ka shpjeguar arsyen e inspektimit. Mund të konsiderohet jo etike por telefoni është pjesë e punës pasi paisja me të cilën punohet online lidhet me internetin nga telefoni dhe jo rrallë herë jep probleme, kontrollohet baza ligjore, hyn në QKB, etj. Pirja e cigares mund të ketë qenë e pavetëdijshme nga inspektori në një situatë tensioni. Së dyti, siç është sqaruar më sipër, baza ligjore mbi të cilën janë bazuar inspektorët parashikon penaltetin 400.000 deri 700.000 lekë për shkeljet e konstatuara dhe siç shihet vlera e vendosur është vlera minimale 400.000 lekë. Së treti, masa urgjente është marrë në datë 15.09.2021, si pasojë e shtyrjes së autorizimit pasi u pretendua se E.M i cili është personi përgjegjës ndodhej jashtë qytetit”.

Me Urdhrin nr. 4106, datë 09.11.2021, Drejtori i Përgjithshëm i AKU ka urdhëruar: “1. Pezullimi⁵ nga detyra të M.K, për shkelje të akteve ligjore e nënligjore, rregullores së institucionit, urdhrave dhe kushteve të kontratës të kryera me faj të rëndë, duke filluar nga data 10.11.2021 deri në një urdhër të dytë”.

Në datë 09.11.2021, Ministri i Drejtësisë ka paraqitur një kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier, kundër shtetasve M.K dhe D.S, për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

⁵ Pezullimi merret pasi ekzistojnë dyshimet e arsyeshme për punonjësin, për të cilin ka nisur ecuria disiplinore që vazhdimi i ushtrimit të detyrës mund të çenojë ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së tij, në drejtim të moszbatimit të urdhrave dhe moskryerjes së inspektimeve.

Me shkresën nr. 5823/1, datë 11.11.2021, Ministri i Drejtësisë në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit ka dërguar pranë AKU-së raportin përfundimtar për çështjen objekt shqyrtimi, në përfundim të të cilit ka propozuar: *“1. Marrjen e masës administrative “Largim nga detyra” për inspektorët e DR AKU Fier, M.K dhe D.S, si persona përgjegjës për veprimet apo mosveprimet, sipas konstatimeve në këtë raport. 2. Fillimin e ecurisë disiplinore për titullarin e DR AKU Fier, Y.A, mbi përgjegjësitë menaxheriale që ka në lidhje me veprimet e inspektorëve në varësi të tij, të cilat rrjellin nga detyrimi i përcaktuar në VKM nr. 708, datë 09.09.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e AKU””.*

Bazuar në propozimin e mësipërm, AKU me Urdhrin nr. 4225, datë 17.11.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm, ka urdhëruar ngritjen e Komisioni Disiplinor për punonjësin M.K, për shqyrtimin e shkeljeve disiplinore të mospërmbushjes së detyrave dhe mosrespektimit të dispozitave ligjore në përmbushjen e detyrave funksionale.

Me shkresën nr. 4225/1, datë 17.11.2021, është njoftuar dhe i është dërguar kopje e materialeve mbi bazën e të cilave ka nisur procedimi disiplinor, M.K për zhvillimin e bisedimeve për zgjidhjen e kontratës së punës, për në datë 23.11.2021.

Referuar procesverbalit nr. 4225/2, datë 23.11.2021 të Komisionit Disiplinor, rezulton se komisioni është mbledhur, por M.K nuk është paraqitur.

Referuar deklarimit të M.K gjatë seancës dëgjimore, rezulton se ai ka marrë dijeni për njoftimin, por duke qenë se ishte në proces penal, nuk kishte mundësi që të bënte diçka sepse nga data 22.11.2021 ishte në masë sigurimi “Arrest me burg”.

Komisioni Disiplinor pas hetimit të thelluar administrativ në lidhje me procedurën e inspektimit të ndjekur nga M.K dhe D.S, ka hartuar relacionin nr. 4225/3, datë 28.12.2021. Në mes të tjerash, Komisioni Disiplinor ka konstatuar se:

- *“Nga shqyrtimi i materialit filmik prej 19 minutash e 30 sekondash, kohë kjo në ushtrimin e detyrës, nuk vihet re asnjë kartë identifikuese e inspektorëve. Në pikën 5.4 të Kodit të Etikës “Për punonjësit e inspektorateve shtetërore në RSH” thuhet se: “Gjatë ushtrimit të detyrës punonjësit e inspektorateve shtetërore duhet të mbajnë në mënyrë të ekspozuar kartën e inspektorit ose kartën e punonjësit”.*
- *Nga shqyrtimi i pamjeve filmike rezulton se, inspektori M.K rri gjithë kohës në telefon, madje ndez dhe cigare në ambientet e brendshme të subjektit. Në nenin 15, germa d) të ligjit nr. 9636, datë 06.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, parashikohet se: “Ndalohej pirja e duhanit: d) mjedise tregtare, bare, restorante, diskoteka dhe klubet e natës”.*
- *Nga shqyrtimi i pamjeve filmike dhe praktikës së inspektimit rezulton se, nga inspektorët nuk kemi pasqyrim të gjendjes reale në praktikën e inspektimit të mbajtur me datë 14.09.2021, pasi aty citohet se “Bazuar në pikën 3, të nenit 29, të ligjit 10433/2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, kërkohet shtyrje e kohëzgjatjes së inspektimit se me datë*

14.09.2021 nuk ishte prezent personi përgjegjës e për pasojë ishte e pamundur verifikimi i dokumentacionit”.

Ndërkohë, nga pamjet filmike rezulton se personi përgjegjës është aty, madje në ndihmë të tij vjen dhe një zonjë e cila vë në dispozicion disa fatura. Njëkohësisht, ankuesi pretendon që nuk i është vënë në dispozicion asnjë dokumentacion për të firmosur, ndërkohë praktika e inspektimit rezulton e refuzuar.

Në nenin 41, germa ç), të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në RSH”, citohet se: “Të kryejë verifikime të dokumenteve për identitetin e personave, kur kjo është e nevojshme, sipas objektit të inspektimit”.

Në pikën 1, të nenit 39, të ligjit për inspektimin, citohet se: “Gjatë inspektimit, inspektori ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë kopje të dokumenteve të veprimtarisë, në përputhje me objektin e inspektimit. Kërkesa bëhet me gojë dhe pasqyrohet në procesverbalin e inspektimit. Çdo kopje dokumenti, i marrë, nënshkruhet nga përfaqësuesi i subjektit të inspektuar”.

Në pikën 1, të nenit 70 (Procedurat e kundërvajtjes, shkeljes) të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për Ushqimin”, citohet se: “Inspektori i AKU shqyrton shkeljet, sipas këtij ligji, dhe merr vendim përfundimtar aty për aty. Vendimi përfundimtar është pjesë e procesverbalit dhe mbahet në vendin e inspektimit dhe i njoftohet, pa vonesë, subjektit të inspektimit ...”.

Në lidhje me konstatimin e sipërcituar, inspektorët M.K dhe D.S nëpërmjet kundërshtimeve të tyre pretendojnë se: “Pasi janë paraqitur në subjekt zotëria që ndodhej aty është prezantuar si shitës dhe se E.M ndodhej jashtë qytetit. Gjithashtu, kemi kërkuar dokumentacionin përkatës por nuk na u vu në dispozicion pasi zonja që erdhi në subjekt paraqiti vetëm fatura të pagesave të sigurimeve shoqërore dhe taksa të ndryshme dhe nuk u paraqit asnjë dokument në lidhje me produktet ushqimore”.

Në lidhje me kundërshtimet e inspektorëve sqarojmë se, në praktikën e inspektimit, rezulton se me datë 14.09.2021 inspektorët M.K dhe D.S janë autorizuar dhe kanë ushtruar kontroll pranë subjektit E.M, pasi kjo verifikohet nëpërmjet pamjeve filmike.

Ndërkohë që me kërkesën nr. AKU-FR-2021-002271-9, datë 14.09.2021, inspektorët M.K dhe D.S, kanë bërë kërkesë për shtyrje të autorizimit të inspektimit me pretendimin se “Mungon personi përgjegjës dhe për këtë arsye nuk është i mundur verifikimi i dokumentacionit”, ndërkohë që siç kemi sqaruar dhe në paragrafin e mësipërm në pamjet filmike të vëna në dispozicion nga vetë subjekti i kontrollit rezulton se inspektorët kanë qenë pranë subjektit në datën 14.09.2021 dhe kanë takuar dhe biseduar (ushtruar kontroll) mbi subjektin e kontrollit E.M.

Prania e E.M gjatë kontrollit konfirmohet nga pamjet filmike, si dhe është verifikuar dhe nëpërmjet Koordinatorit kundër Korrupsionit pranë Gjendjes Civile, i cili me e-mailin e datës 04.11.2021 konfirmon që personi në pamjet filmike është pikërisht E.M. Për më tepër, që inspektorët kanë detyrim të kërkojnë mjete identifikimi për personat që ndodhen në subjekt.

Ndërkohë, autorizimi për kontroll është shtyrë për datën 15.09.2021 dhe inspektorët sipas ankuesit janë paraqitur pranë subjektit, por nuk i kanë vënë në dispozicion asnjë shkresë.

Në procesverbalin e inspektimit të mbajtur në datë 15.09.2021 trupa inspektuese ka shënuar: data e fillimit 14.09.2021, ora e fillimit 09.30 dhe data e mbarimit 14.09.2021, ora e mbarimit 12.40. Bazuar në procesverbalin e inspektimit, Komisioni Disiplinor vlerëson se procedura e inspektimit është përfunduar brenda datës 14.09.2021, ndërsa Listë Verifikimi në të cilën janë shënuar shkeljet është plotësuar me datë 15.09.2021. Ky veprim bie në kundërshtim me pikën 4, të Shtojcës 2, të Urdhrit nr. 25, datë 10.08.2018, Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ” ku sanksionohet se: “Procesverbali i inspektimit dhe vendimi përfundimtar bazohet në gjetjet e konstatuara gjatë verifikimit të listës së verifikimit. Procesverbali i inspektimit dhe vendimi përfundimtar nënshkruhen nga trupa e inspektimit dhe nga përfaqësuesi i subjektit objekt inspektimi, në vendin ku kryhet inspektimi”. Pra, Komisioni Disiplinor konkludon se procesverbali është plotësuar para se të plotësohet Listë Verifikimi.

Gjithashtu, trupa inspektuese edhe pse me datë 14.09.2021 ka përfunduar procedurën e inspektimit, ka bërë kërkesë për shtyrje të kohëzgjatjes së autorizimit, me arsyetimin se “mungon personi përgjegjës dhe për këtë nuk është i mundur verifikimi i dokumentacionit”, ndërkohë po në datë 14.09.2021 ka përfunduar procedurën e inspektimit. Ky veprim bie në kundërshtim me pikën 2, të nenit 29, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në RSH”, i cili sanksionon se: “Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji i posaçëm, në raste përjashtimore, për shkak të kompleksitetit të veprimeve të inspektimit, kohëzgjatja mund të shtyhet me një herë të vetme dhe për një periudhë jo më të madhe se kohëzgjatja fillestare”. Pra, përderisa procedura e inspektimit ka përfunduar, kërkesa për shtyrje të kohëzgjatjes së autorizimit e bërë nga ana e trupës inspektuese nuk legjitimohet.

Mbajtja e vendimit përfundimtar të inspektimit datë 15.09.2021 është në kundërshtim me pikën 1, të nenit 70, të ligjit nr. 9683, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar, i cili sanksionon se: “Inspektori i AKU shqyrton shkeljet, sipas këtij ligji dhe merr vendim përfundimtar aty për aty”. Pra, Komisioni Disiplinor arsyeton se përderisa inspektimi ka përfunduar me datë 14.09.2021, inspektorët duhet të kishin marrë vendim përfundimtar po në datë 14.09.2021.

Komisioni konkludon se nga ana e nëpunësit janë kryer shkeljet disiplinore “Mospërbushje e rëndë e detyrave” dhe “Moszbatim haptazi i dispozitave ligjore për përbushjen e detyrave funksionale”, parashikuar nga neni 16 i kontratës individuale të punës dhe klasifikohen përfundimisht nga Komisioni i Disiplinës si shkelje të rënda, të cilat kanë sjellë pasoja shumë të rënda në aspektin e cënimit të sigurisë ushqimore.

Në përfundim të shqyrtimit të masës disiplinore dhe hetimit administrativ Komisioni i Disiplinës, pasi kreu një hetim të plotë lidhur me shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e ardhura prej saj, shkallën e fajësisë vendosi ti propozojë Drejtorit të Përgjithshëm dhënien e masës disiplinore “largim nga puna” për M.K”.

Me Urdhrin nr. 4766, datë 28.12.2021, Drejtori i Përgjithshëm i AKU, ka urdhëruar largimin nga detyra të M.K për shkelje të rënda disiplinore “*Mospërbushje e rëndë e detyrave*” dhe “*Moszbatimi haptazi i dispozitave ligjore për përbushjen e detyrave funksionale*”, të kryera me faj të rëndë, të konstatuara në praktikën e subjektit E.M.

Subjekti ankues pretendon se largimi i tij nga puna është bërë për shkak se ka qenë në proces gjyqësor.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesi, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ankuesi i është nënshtruar ndonjë trajtimi të padrejtë, të pabarabartë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën e tij për punësim në lidhje me zgjidhjen e marrëdhënieve të punës. Nëse konstatohet se ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, atëherë do të vijohet me analizën, nëse ky trajtim të cilit i është nënshtruar ankuesi ka ardhur apo jo si rezultat i shkakut të pretenduar, i cili duhet gjithashtu të provohet dhe gëzon mbrojtje nga ligji.

Sipas nenit 12, të Kodit të Punës, kontrata e punës është një marrëveshje ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, që rregullon marrëdhëniet e punës dhe përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve. Në kontratën e punës punëmarrësi merr përsipër të ofrojë punën ose shërbimin e vet për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar kohe, në kuadër të organizimit dhe të urdhrave të një personi tjetër, të quajtur punëdhënës, i cili merr përsipër të paguajë një shpërblim.

Bazuar në Kontratën Individuale të Punës nënshkruar me datë 01.04.2020, mes punëdhënësit/AKU dhe punëmarrësit/ankuesit, në nenin 3, të saj, përcaktohet si më poshtë citohet: “*3.1. Palët bien dakord dhe lidhin këtë kontratë pune për një kohë të pacaktuar. 3.2. 3 muajt e parë të punës konsiderohen kohë prove. 3.3. Në përfundim të periudhës së provës, nëse punëdhënësi nuk e ka zgjidhur kontratën, atëherë punëdhënësi ka pranuar që kjo kontratë do të shtrijë efektet e saj sipas një afati të pacaktuar*”.

Neni 21⁶, i Kodit të Punës, në pikën 2, të tij, ka përcaktuar se: “*Kontrata e punës quhet e lidhur kur punëmarrësi pranon kryerjen e një pune ose shërbimi, për një periudhë kohe të caktuar ose të pacaktuar, brenda kuadrit të organizimit dhe sipas urdhrave të punëmarrësit dhe që, në bazë të këtyre rrethanave, kryhet vetëm kundrejt pagesës*”.

Për rrjedhojë, në këto kushte, kemi të bëjmë me një kontratë me afat të pacaktuar, pasi punëdhënësi e punëmarrësi kanë vijuar marrëdhëniet e punës, nga data 01.07.2010 deri me datë 29.12.2021.

Organizimi dhe funksionimi i AKU-së rregullohet sipas parashikimeve të bëra në VKM nr. 708, datë 09.09.2020. Në Kreun III, pika 3 e VKM-së, parashikohet se: “*AKU-ja drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili përgjigjet te ministri dhe përfaqëson AKU-në në marrëdhënie me të tretët*”. Në Kreun III, neni 8 të kësaj VKM-je janë parashikuar dhe detyrat e drejtorit të përgjithshëm, në të cilën përcaktohen se: “*Drejtori i Përgjithshëm i AKU-së, përveç sa është parashikuar në ligjin*

⁶ “*Forma e kontratës së punës*”.

përkatës për ushqimin, kryen detyrat e mëposhtme: “..... d) përgatit dhe përcjell për miratim pranë ministrit rregulloren që përcakton metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit; f) nxjerr akte të brendshme për menaxhimin administrativ, financiar, të burimeve njerëzore dhe akte të tjera të brendshme të detyrueshme për nëpunësit e AKU-së, për realizimin e funksioneve të këtij institucioni;”.

Me Urdhrin nr. 297, datë 23.06.2022 të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, është miratuar rregullorja për organizimin dhe funksionimin e AKU-së.

Në nenin 14 të kësaj Rregulloreje janë parashikuar kompetencat dhe detyrat e Drejtorit të Përgjithshëm, në të cilat në pikën g) është përcaktuar se: *“Drejtori i Përgjithshëm i AKU-së është përgjegjës për veprimtarinë e këtij autoriteti dhe përveç sa parashikohet në ligj, ka këto kompetenca dhe detyra kryesore: g) nxjerr akte të brendshme për menaxhimin administrativ, financiar, të burimeve njerëzore dhe akte të tjera të brendshme të detyrueshme për nëpunësin/punonjësit e AKU-së, për realizimin e funksioneve të këtij institucioni;”,* ndërsa në nenin 38 përcaktohet se: *“Drejtori i Shërbimeve të Brendshme ka këto detyra dhe përgjegjësi kryesore: “..... g) mbikqyr procedurat disiplinore ndaj punonjësve të AKU dhe drejton veprimtarinë e Komisionit të Përhershëm të Shqyrtimit të Shkeljeve Disiplinore, sipas përbërjes të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm”.*

Në nenin 16 të rregullores parashikohen dhe detyrat e Koordinatorit të Rrejtit Kundër Korrupsionit, në të cilin parashikohet se: *“1. Koordinatori i rrejtit kundër korrupsionit funksionon pranë Drejtorisë së përgjithshme të AKU-së dhe emërohet nga Drejtori i Përgjithshëm me propozimin e Ministrit të Drejtësisë. a) Koordinatori i rrejtit kundër korrupsionit ka si qëllim parandalimin dhe goditjen e korrupsionit në institucion, si dhe vlerësimin e rrezikut kundër korrupsionit dhe kryen detyrat e mëposhtme: b) mbledh informacion për veprimtarinë korruptive, praktikat abuzive apo arbitrare nga burime të ndryshme dhe kryen hetime administrative brenda fushës së përgjegjësisë së institucionit; c) bashkëpunon me strukturat e brendshme të AKU për shqyrtimin e rasteve të korrupsionit; f) harton raportin përfundimtar të rastit, objekt verifikimi, dhe e përcjell atë pranë sturkturës përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë; g) kryen çdo detyrë tjetër të parashikuar në VKM nr. 618, datë 20.10.2021 “Për krijimin, organizimin e funksionimin e rrejtit të koordinatorëve kundër korrupsionit”, ose të deleguar nga Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit apo struktura përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë në përputhje me kompetencat e tij;”.*

Në nenin 16 të Kontratës individuale të punës nr. 1474/3, datë 01.04.2020, të lidhur mes palëve parashikohen se: *“Shkeljet dhe masat disiplinore. 16.1. Për shkelje të akteve ligjore e nënligjore të rregullores së institucionit, Urdhrave dhe kushteve të kësaj kontrate ndaj punëmarrësit do merren masa disiplinore. 16.5. Do të quhen shkelje të rënda rastet e mëposhtme: a) mospërbushja e detyrave; c) moszbatimi haptazi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 16.6. Për shkelje disiplinore, punëdhënësi merr këto masa disiplinore: b) për shkeljet e rënda jepet masë disiplinore “largim nga puna” e cila shoqërohet me zgjidhjen e menjëhershme të*

kontratës së punës. 16.7. Në rast zgjidhje të kontratës së punës sipas pikës 16.6, zbatohen dispozitat e Kodit të Punës për këto raste”.

Referuar marrëdhënieve të punësimit, vlerësohet se secila nga palët ka të drejtën që të zgjidhë kontratën e punës në mënyrë të njëanshme. Kodi i Punës parashikon rregullat, procedurat dhe afatet që duhet të respektohen nga palët të cilat kanë hyrë në një marrëdhënie juridike punësimi dhe kanë lidhur midis tyre kontratën individuale të punës. Kodi i Punës parashikon dy mënyra të zgjidhjes së kontratës së punës, zgjidhjen normale dhe zgjidhjen e menjëhershme. Në të dyja rastet palët kanë detyrimin që të respektojnë procedurën dhe afatet e përcaktuara.

Në nenin 144 të Kodit të Punës parashikohet se:

- 1. Pas kohës së marrjes në provë, kur punëdhënësi mendon të zgjidhë kontratën e punës, ai duhet të njoftojë me shkrim punëmarrësin të paktën 72 orë para takimit dhe të bisedojë me të.*
- 2. Punëdhënësi, gjatë kësaj bisede, i parashtron punëmarrësit arsyet e vendimit të parashikuar për t’u marrë dhe i jep atij mundësi për t’u shprehur.*
- 3. Zgjidhja njoftohet me shkrim, brenda një afati nga 48 orë deri në një javë pas takimit. Në njoftimin me shkrim, punëdhënësi përcakton arsyet e zgjidhjes së kontratës, të cilat lidhen me shkaqe të tilla si aftësia, sjellja e punëmarrësit ose kërkesat operationale të ndërmarrjes.*

Në nenin 153 të Kodit të Punës parashikohet se:

- 1. Punëdhënësi e punëmarrësi, në çdo kohë, mund të zgjidhin menjëherë kontratën për shkaqe të justifikuara.*
- 2. Vlerësohen si shkaqe të justifikuara të gjitha rrethanat e rënda që nuk lejojnë, sipas parimit të mirëbesimit, t’i kërkohej atij që ka zgjidhur kontratën, vazhdimin e marrëdhënieve të punës.*
- 3. Gjykata vendos nëse ekzistojnë shkaqe të justifikuara për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës. Konsiderohen shkaqe të justifikuara rastet kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të rëndë, si edhe rastet kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të lehtë, në mënyrë të përsëritur , me gjithë paralajmërimin me shkrim të punëdhënësit.*

Në zbatim të legjislacionit të cipërcituar, Komisioneri vlerëson se Ministri i Drejtësisë në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, në përfundim të shqyrtimit të plotë të ankesës së shtetasit E.M dhe pas shqyrtimit të parashtrimeve të trupës inspektuese M.K dhe D.S, me shkresën nr. 5823/1, datë 11.11.2021 “Raport Përfundimtar” ka propozuar marrjen e masës administrative “Largim nga puna” për inspektorët M.K dhe D.S, sipas konstatimeve të raportit.

Drejtori i Përgjithshëm i AKU, në zbatim të detyrave të tij dhe të propozimit të Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit me shkresën nr. 4225, datë 17.11.2021 ka urdhëruar ngritjen e

Komisionit Disiplinor për punonjësin M.K, të përbërë nga 5 anëtare dhe të kryesuar nga Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme.

Me shkresën nr. 4225/1, datë 17.11.2021, “Njoftim për bisedime për zgjidhjen e kontratës së punës”, AKU ka njoftuar ankuesin për zhvillimin e takimit në datë 23.11.2021, si dhe i ka dërguar kopje të materialeve mbi bazën e të cilave ka nisur procedimi disiplinor. Referuar deklarimeve të M.K (në formularin e ankesës dhe deklarimit gjatë seances dëgjimore) rezulton se ai ka marrë dijeni për njoftimin për bisedime dhe është vënë në dijeni të materialeve mbi bazën e të cilave kishte nisur procedimi disiplinor, por duke qenë se ishte i akuzuar në një proces penal dhe në datë 22.11.2021 për të ishte marrë masa e sigurisë “arrest me burg”, nuk ka ndërmarrë veprime për të kundërshtuar vetë apo nëpërmjet një përfaqësuesi ligjor, procedurën e nisur për masë disiplinore.

Referuar Relacionit nr. 4225/3, datë 28.12.2021, të Komisionit Disiplinor, rezulton se komisioni ka shqyrtuar të gjithë dokumentacionin e administruar si, pamjet filmike dhe praktikën e inspektimit dhe ka konkluduar (referuar në faqen 18 të këtij vendimi) se nga ana e M.K janë kryer shkelje disiplinore dhe ka propozuar dhënie të masës disiplinore “largim nga puna”.

Në vijim, Drejtori i Përgjithshëm i AKU, me Urdhrin nr. 4766, datë 28.12.2021, “Largim nga Detyra”, në bazë të nenit 144, 153, 154 të Kodit të Punës, ka urdhëruar largimin nga detyra të M.K për shkelje të rënda disiplinore “*Mospërmbushje e rëndë e detyrave*” dhe “*Moszbatimi haptazi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale*”, të kryera me faj të rëndë, të konstatuara në praktikën e subjektit E.M.

Për sa më lart, Komisioneri vlerëson se procedura e ndjekur dhe vendimmarrja nga ana e AKU-së, rezulton e marrë në përfundim të një procesi të rregullt ligjor.

Në këto kushte provohet se ankuesi nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme dhe se zgjidhja e kontratës së punës, nuk është bërë në shkelje të procedurës ligjore që duhet ndjekur për përfundimin e marrëdhënies së punës.

Në analizë të veprimeve të kryera nga AKU rezulton se nga ana e këtij institucioni janë kryer të njëjtat veprime dhe është mbajtur i njëjti qëndrim lidhur me trajtimin e ankesave nga subjektet dhe të denoncuara në media dhe për inspektoren D.S, pjesë e trupës së inspektimit, e cila me Urdhrin nr. 4767, datë 28.12.2021 është larguar nga detyra, ashtu dhe për inspektorin E.Sh, i cili me Urdhrin nr. 7751/11, datë 31.03.2020 i është dhënë masa disiplinore “Largim nga shërbimi civil”.

Në përfundim, Komisioneri gjatë analizës së informacionit dhe provave të sipërcituara, konstatoi se:

- Nga ana e AKU-së, janë ndjekur të gjithë procedurat dhe hapat, në mbështetje të akteve ligjore/nënligjore, për shqyrtimin e ankesës në ngarkim të M.K dhe është ndjekur procedura ligjore për zgjidhjen e marrëdhënies së punës.

- Ankuesi nuk është vendosur në kushte të pabarabarta nga ana e AKU-së, pasi ky institucion ka ndjekur të njëjtën procedurë dhe ka mbajtur të njëjtin qëndrim dhe për shqyrtimin e rasteve të tjera për dhënien e masave disiplinore.

Diskriminimi përkufizohet në nenin 3, pika 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si nga ligjet në fuqi”.

Në nenin 12/1/c) të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: c) trajtimin e punëmërrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7/1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri vlerëson se Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, nuk ka ndërmarrë veprime që e kanë ekspozuar subjektin ankues ndaj një trajtimi të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Në mungesë të këtij trajtimi, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje të paligjshme dhe të pabarabartë nga ana e AKU-së, për shkakun e pretenduar nga ankuesi dhe për rrjedhojë nuk provohet se Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit M.K, në të drejtën për punësim, për shkak se ishte në proces gjyqësor nga ana e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijëni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA